

## DOKUMENTI KONSULTATIV

### Për projektligjin “Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat”

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në kuadër të procesit të konsultimit “Për projektligjin “Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat” mirëpret sugjerimet nga qytetarët, ekspertë të fushës, nga të gjitha institucionet dhe subjektet e interesuara, organizata jofitimprurëse, shoqëria civile, të drejtat ose objekti i veprimtarisë të cilave ka të bëjë apo ndikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo nga përcaktimet e kësaj nisme.

#### Kohëzgjatja e konsultimeve:

Konsultimet në portalin e Regjistrimit Elektronik: 20 ditë pune, duke filluar nga data 9.5.2025  
6.6.2025.

#### Si të përgjigjeni:

Kontributet që në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit të përmbajtjes së projektligjit, do të përcillen nga institucionet e interesuara me anë të regjistrimit elektronik në adresën <http://www.konsultimipublik.gov.al>.

#### Kontakti:

Emiliano Gjika: Emiliano.Gjika@atrako.gov.al

Olsi Kota: Olsi.Kota@meki.gov.al

#### Datat dhe vendet e takimeve publike:

E-Konsultimi: në portalin “Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike” 20 ditë pune, duke filluar nga data 9 Maj 2025.

#### Sfondi i propozimit legjislativ

Projektligji “Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat” (në vijim Projektligji) ka për qëllim krijimin e një kuadri të qartë, të qëndrueshëm dhe konkurrues për nxitjen e investimeve private nëpërmjet koncesioneve dhe partneriteteve publike-private (PPP). Projektligji përcakton rregullat për planifikimin, dhënien, administrimin dhe mbikëqyrjen e kontratave të koncesionit/partneritetit publik-privat, duke u mbështetur në parimet e transparencës, mosdiskriminimit, proporcionalitetit, efikasitetit dhe sigurisë juridike.

#### Propozimet

Ky projektligj ka si përparësi dhe efekte të pritshme:

- i. krijimin e një kornize të unifikuar për procedurat konkurruese;

- ii. ruajtjen e interesit publik nëpërmjet kontrollit ex-ante dhe ex-post të ministrisë përgjegjëse për financat;
- iii. siguron rregulla transparente për dhënien, zbatimin dhe monitorimin e kontratave të koncesionit dhe PPP;
- iv. vendos mekanizma për ndarjen dhe menaxhimin e risqeve;
- v. harmonizon procedurat me standardet e BE-së për dhënien e kontratave të koncesionit;
- vi. forcon rolin mbikëqyrës të ministrisë përgjegjëse për financat, Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) dhe Agjencisë së Trajtitit të Koncesioneve (ATRAKO);
- vii. promovon vlerën më të mirë për paranë (value for money) dhe mbrojtjen e interesit publik.

### **Pyetjet**

Reagimet që priten janë të hapura dhe nuk parashikohet ngritja e pyetjeve specifike, të cilat kërkojnë përgjigje. Pyetje të mundshme mund të jenë: A pajtoheni me qartësinë e informacionit të paraqitur në dokument dhe çfarë do të propozonit shtesë për të përmirësuar cilësinë e tij? Si i vlerësoni përcaktimet në këtë projektligj.